

Sesion dhurimi vullnetar të gjakut në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar Dega Elbasan dhe Bankën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, organizuan sesion dhurimi vullnetar të gjakut në ambjentet e universitetit, nën moton "Dhuro gjak, shpëto një jetë!".

Si çdo vit tjetër, u vërejt një gatishmëri e madhe e studentëve, personelit akademik dhe punonjësve tjerë të këtij institucioni për t'ju bashkuar kësaj nisme, kontributi i të cilëve do t'ju vijë në ndihmë fëmijëve Talasemikë.



